



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMI I KURRIKULËS BËRTHAMË PËR SHKOLLAT E MESME TË  
GJUHËVE TË HUAJA**

**FUSHA: GJUHË E HUAJ**

**LËNDA: GJUHË ANGLEZE**

**KODI:3.1.11.B**

**PROGRAMI I LËNDËS  
GJUHË ANGLEZE  
PËR KLASËN E 11-të**

**Koordinatori: ERIFILI HASHORVA**

**Redaktori:GAZMEND KRASNIQI**

**Përgjegjës sektori:MARITA HAMZA**

**TIRANË, KORRIK 2010**

Objektivi kryesor i këtij programi të gjuhës angleze për **klasën e 11-të** është që të mundësojë nxënësit që të arrijnë një nivel gjuhësor **B1+** (sipas KPER); ku pa dyshim do të përfshihen të gjitha aftësitë gjuhësore, si ato të lexuarit, të folurit, të shkruarit dhe të dëgjimit. Në përfundim, nxënësi duhet të jetë i aftë të kuptojë elementet bazë gramatikore të gjuhës angleze.

Ky program është ndërtuar duke marrë parasysh interesat dhe karakteristikat e grup-moshës dhe kontribuon në zhvillimin e pavarur, intelektual dhe socio-kulturor të nxënësve, në mënyrë që ata të përballojnë të nxënët gjatë gjithë jetës. Programi ofron mundësi për nxënësin që ai të mund të zhvillojë e zgjerojë edhe më tej elementet bazë të mësimi të gjuhës angleze për një përvetësim sa më të mirë e praktik të saj.

Programi shpalos mundësi e nxit forma të pune që mësimi dhe përvetësimi i anglishtes të jetë në funksion të objektivit madhor të integritit të nxënësve në një shoqëri demokratike dhe përmbushjes së kërkesave të tyre për një arsimim të mëtejshëm përherë më cilësor dhe më të suksesshëm. Ai synon të zhvillojë të menduarit kritik dhe të pavarur të nxënësit në klasë e jashtë saj, duke dhënë forma të ndryshme të punës individuale dhe të asaj të integruar në grup.

Ky programi lidhet harmonishëm edhe me programet ndërkurrikulare të kësaj klase si p.sh., në histori, gjeografi, letërsi, matematikë, biologji, informatikë etj., duke i ndërthurur këto dije në mënyrë logjike. Po ashtu, ky program synon t'i japë nxënësit një njohje të mirë edhe për kulturën, artin dhe jetën shoqërore të vendeve anglishtfolëse. Këto dije e përgatisin nxënësin gjithashtu të ndjekë e të përballë me studime të mëtejshme si dhe me punësim të përshtatshëm brenda ose jashtë vendit.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11-të është konceptuar dhe përpiluar në mënyrë të tillë që, me anë të dijeve që nxënësi merr gjatë procesit mësimor, të zhvillojë personalitetin e tij, duke rritur besimin dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vetes dhe shoqërisë.

## 1. SYNIMI I LËNDËS

Në këtë nivel, synimi kryesor i mësimi të anglishtes është të përsërisë dhe të përforcojë edhe më tej aftësitë e përfituara nga nxënësit në nivelin e mëparshëm të kalojë në atë **B1+**, në mësimin e kësaj gjuhe, duke u aftësuar gjithnjë e më shumë si përdorues të pavarur i saj. Niveli **B1+** arrihet në vitin e 11-të në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja sepse nxënësit bëjnë 4 orë në javë anglisht në ndryshim me vitin e 11-të të gjimnazit të cilët bëjnë 3 orë në javë. Programi i ri i mësimi të anglishtes për klasën e 11-të përbën një hap tjetër përpara në përsosjen e mësimi të anglishtes në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja.

Programi i gjuhës angleze **për klasën e 11-të** synon të përforcojë dhe të zgjerojë njohuritë për materialet gjuhësore dhe gramatikore, të zhvillojë më tej njohjen për dimensionin kulturor dhe shoqëror të vendeve anglishtfolëse, të përsosë aftësitë komunikuese në gjuhën angleze dhe ato të shkrimit leximit dhe të kuptuarit të kësaj gjuhe.

## 2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:

- të përforcojë dhe zgjerojë njohuritë për materialet gjuhësore dhe gramatikore dhe me anë të teksteve mësimore, mjeteve audio-vizive origjinale si edhe përmes teknikave dhe

metodave moderne interaktive, për një përvetësim të thelluar të anglishtes në mënyrë që nxënësi të zotërojë njohje të qëndrueshme dhe komunikim të lirshëm në këtë gjuhë;

- të zhvillojë mendimin e pavarur dhe kritik për të gjitha aspektet gjuhësore, kulturore dhe shoqërore;
- të zhvillojë më tej njohjen për dimensionin kulturor dhe shoqëror të vendeve anglishtfolëse;
- të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendeve anglishtfolëse dhe kulturës amtare;
- të përsosë aftësitë komunikuese dhe zbatimin e njohurive gjuhësore dhe gramatikore në situata të ndryshme të jetës së përditshme;
- të forcojë ndërveprimin në situata jashtëshkollore të cilat kanë lidhje me temat e zhvilluara në orët mësimore;
- të jetë në gjendje të shkruajë, të lexojë, të dëgjojë dhe të kuptojë tekste, pjesë dëgjimore, etj. në gjuhën angleze;

### 3.OBJEKTIVA

#### a) Objektivat sipas standardit në komunikim

**Përshkrimi:** Objektivat në këtë fushë janë përsosja e bazës së gjuhës angleze, të cilën nxënësit e kanë përfituar në ciklin e mëparshëm, si domosdoshmëri për një komunikim me një standard gjuhësor të nivelit **B1+**. Kjo do të arrihet me anë të situatave të ndryshme, të përshtatshme për grup-moshën e tyre, të cilat do t'i mundësojnë nxënësit të përfitojnë njohuri gjuhësore të nevojshme për të përballuar situata të komunikimit të përditshëm në një mjedis gjuhësor e kulturor anglishtfolës.

Standardi në këtë fushë forcon, pasuron dhe thellon dijet e përgjithshme të nxënësit dhe e aftëson atë si nga ana gjuhësore ashtu edhe nga ana komunikative për përballjen me gjuhën dhe kulturën angleze.

	<b>Objektiva</b>
<b>Komunikim dhe Veprimtaritë në komunikim</b>	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të shprehet në mënyrë të qartë në një sërë fushash të komunikimit të përditshëm, si në shkollë, në shtëpi, në punë, në ambientet e argëtimit, në situata të ndryshme formale dhe joformale;</li> <li>• të flasë në përgjithësi dhe me fjalor të kënaqshëm për subjektin e një libri, filmi, veprë arti në muzikë, pikturë, etj.;</li> <li>• të flasë në përgjithësi dhe me fjalor të kënaqshëm për një ngjarje historike apo shoqërore si të kulturës anglo-amerikane po ashtu edhe të asaj amtare;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të bëjë sugjerime si edhe të ofrojë dhe parashtrijë zgjidhje të ndryshme;</li> <li>• të shprehë mendime kritike për debate të fushave të ndryshme të përmendura më sipër;</li> <li>• të paraqesë e të ofrojë ide alternative dhe të debatojë rreth tyre me fjalor të kënaqshëm;</li> <li>• të fillojë dhe të mbështesë debate për zgjidhje të problemeve në familje, në klasë dhe shoqëri;</li> <li>• të kuptojë thelbin e një bisede deri në detaje dhe të jetë në gjendje të shpjegojë atë edhe për të tjerët;</li> <li>• të përshkruajë njerëz, vende dhe ngjarje deri në detaje të kuptueshme;</li> <li>• të krahasojë mendime, ide, kultura, vende dhe aspekte shoqërore të kulturave anglishtfolëse me ato të vendit amtar;</li> <li>• të bëjë analiza e të nxjerrë përfundime nga situata të ndryshme si, p.sh., jeta e përditshme, jeta në shkollë, bota përreth nesh, bota e komunikimit, jeta personale e shoqërore, të drejtat dhe liritë e njeriut, etj., duke përdorur një fjalor të kënaqshëm në gjuhën angleze;</li> <li>• të shprehë lirisht akte të tilla komunikimi si: përshëndetje, prezantim, miratim, vlerësim, gëzim, keqardhje, mirënjohje, mospëlqim, protestë, kundërshtim, ftesë, mundësi, pamundësi, hipoteza reale dhe imagjinare etj.;</li> <li>• të kërkojë falje apo ndjesë në mënyrë të kulturuar;</li> <li>• të nxisë dhe të shprehë detyrime;</li> <li>• të përjetojë përvoja të ndryshme, në situata të jetës së përditshme si: takime, ditëlindje, shitblerje, telefonata, dërgim email-i, udhëtime në vende të panjohura, shkollë, mbrëmje, ekskursionet etj.</li> </ul>
--	---

## b) Objektivat sipas standardit në kulturë

**Përshkrimi:** Objektivat thelbësore në fushën kulturore parashikojnë një shkallë më të lartë të ndërgjegjësimit kulturor duke vënë theksin në administrimin e aftësive ligjërimore në ndërveprimin gjuhësor dhe kulturor.

	<b>Objektiva</b>
<b>Kultura</b>	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të zgjerojë ndjeshëm njohuritë për kulturën, letërsinë dhe shoqërinë angleze dhe amerikane;</li> <li>• të ketë informacion për jetën shoqërore të përfituar prej burimeve të tilla të informacionit si: shtypi, televizioni, radioja dhe veçanërisht interneti;</li> <li>• të njohë larmitë e ndryshme të stileve të jetesës të vendeve të ndryshme anglishtfolëse, dimensionet kulturore nga vende të tilla, mënyrat e kalimit të kohës së lirë, të zgjedhjes së pushimeve, sportet më të parapëlqyera, mënyrat e gatimit, llojet e muzikës, festat zyrtare dhe ato familjare etj.;</li> <li>• të zotërojë mënyrat e komunikimit, kërkimit, hulumtimit në internet për këto aspekte kulturore të vendeve anglishtfolëse;</li> <li>• të njohë monumente të artit, personalitete, ngjarje të rëndësishme të historisë dhe të aktualitetit të vendeve anglishtfolëse;</li> <li>• të mund të flasë për shijet e të rinjve, tregun, çmimet, modën, muzikën, kuzhinën, të drejtën dhe lirinë etj.</li> <li>• të njohë kinemanë apo këngën angleze dhe amerikane, si dhe të mund të bëjë komente mbi to (të shprehë admirimin, pëlqim, mospëlqim, shije të tjera).</li> </ul>

### c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

**Përshkrimi:** Objektivat e standardit në këtë fushë e aftësojnë nxënësin të prodhojë elemente gjuhësore që i përkasin nivelit **B1+**. Përmes praktikimit nxënësi do të nxitet të përdorë struktura gramatikore të gjuhës angleze, si ato të përfituar në nivelin e mëparshëm po ashtu edhe struktura të reja, si dhe të kuptojë saktësisht përdorimin të tyre duke gjetur edhe gjegjëset e tyre në gjuhën amtare. Këtu vihet theksi në pasurimin, konsolidimin dhe zgjerimin e njohurive gramatikore të përftuara në nivelet e mëparshme gjuhësore.

	<b>Objektiva</b>
<b>Elemente gramatikore</b>	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përdorë dhe të dallojë saktë elementet kryesore të morfologjisë dhe sintaksës së gjuhës angleze;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përdorë dhe të dallojë në mënyrë të saktë të gjitha format bazë të foljeve dhe</li> <li>• të përdorë dhe të japë shembuj në mënyrë krijuese duke dhënë kombinime të ndryshme të foljeve;</li> <li>• të përdorë formën veprorë dhe joveprorë të foljeve në struktura të ndërlikuara, ligjëratën e drejtë dhe atë të zhdrejtë në funksion të komunikimit;</li> <li>• të njohë përdorimin e tri formave të fjalive kushtore në gjuhën angleze;</li> <li>• të përdorë mirë fjalët pyetëse dhe të kuptojë strukturën e fjalive pyetëse;</li> <li>• të njohë lidhëzat e ndryshme dhe fjalitë e varura kohore;</li> <li>• të përdorë foljet frazale dhe ato modale kryesore dhe modalitetet që ato shprehin;</li> <li>• të përdorë me një korrektësi të mjaftueshme një repertor të shprehjeve dhe frazave që përdoren shpesh;       <ul style="list-style-type: none"> <li>---të komunikojë me një saktësi të mjaftueshme gramatikore</li> <li>---të përdorë me efikasitet një larmi të madhe fjalësh lidhëse për të shënuar qartë marrëdhëniet midis ideve.</li> </ul> </li> </ul>
--	---

#### 4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Më poshtë vijon, përshkrimi i objektivave sipas katër aftësive bazë të gjuhës: **të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit**. Këto aftësi gjuhësore ndërthuren me njëra-tjetrën gjatë procesit mësimor për të arritur një përvetësim sa më të mirë të gjuhës së huaj nga ana e nxënësit.

Aftësia	Objektiva
<b>Të dëgjuarit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të ndjekë biseda të përditshme të artikuluar qartë që i drejtohen atij.</li> <li>• të ndjekë thelbin e një bisede të zgjatur rreth tij, kur gjuha e folur është e artikuluar qartë dhe kur është përdorur një gjuhë standarde.</li> <li>• të dëgjojë një tekst të shkurtër dhe të ngrejë hipoteza rreth asaj që do të ndodhë më pas.</li> <li>• të kuptojë çështje kryesore në buletine lajmesh si edhe materiale të tjera të regjistruara të shprehura</li> </ul>

	<p>relativisht qartë dhe ngadalë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të kapë thelbin e programeve televizive mbi tema të njohura kur ngjarjet e treguara shoqërohen me veprime dhe figura.</li> <li>• të kuptojë të dhëna teknike për instrumente të veprimtarisë së tij, si të dhëna për një kompjuter, makinë llogaritëse, televizor etj.</li> <li>• të reagojë ndaj udhëzimeve dhe këshillave, duke iu përgjigjur situatave me një fjalor të njohur ose të dëgjuar më parë.</li> <li>• të kuptojë pyetje të ndryshme dhe përgjigje të drejtuara në formë pohimesh ose mohimesh të shqiptuara me një shpejtësi normale.</li> <li>• të kuptojë monologë, dialogë dhe pyetësorë të shprehura me një ritëm normal</li> <li>• të ndajë qëndrimet e folësve në diskutime për tema të njohura lidhur me kohën e lirë, familjen dhe shkollën, kur gjuha është e qartë dhe standarde</li> <li>• të përcaktojë pikat kryesore të një diskutimi ose përshtkrimi relativisht të gjatë kur gjuha është e qartë; <ul style="list-style-type: none"> <li>○ të tregojë me anën e përsëritjes, mimikës, gjesteve dhe elementeve të tjera brendinë e pjesëve të dëgjuara.</li> </ul> </li> </ul>
<b>Aftësia</b>	<b>Objektiva</b>
<b>Të folurit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të fillojë dhe të përfundojë me bashkëfolësin një bisedë për një temë shumë të njohur ose që i paraqet interes;</li> <li>• të marrë pjesë në një bisedë apo diskutim, ku ai shpreh qartë atë që ai dëshiron të thotë;</li> <li>• të përballojë shumicën e situatave që mund t'i paraqiten, të tilla si: rezervimi i një udhëtimi pranë një agjencie, kërkim informacioni për të gjetur një rrugë si edhe të ndjekë këshillat që i japin për këtë gjë;</li> <li>• të shprehë ndjenja të tilla si habia, gëzimi, trishtimi, kureshtja, indiferenca, si edhe të reagojë ndaj të njëjtave ndjenja të shprehura nga të tjerët;</li> <li>• të shkëmbejë pikëpamje apo të shprehë mendime vetjake në një diskutim midis miqsh dhe të njohurish;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të shprehë me mirësjellje nëse e pranon diçka apo jo;</li> <li>• të tregojë një histori apo përvojë në detaje si edhe të përshkruajë ndjenjat dhe reagimet e tij;</li> <li>• të sqarojë shkurt qëllimet, planet dhe veprimet e tij;</li> <li>• të tregojë përmbajtjen e një libri apo të një filmi dhe të përshkruajë reagimet e tij;</li> <li>• të përsërisë pjesërisht ato që i thotë folësi për tu siguruar që kuptohen ndërmjet tyre;</li> <li>• të përdorë një fjalë tjetër më të thjeshtë në vend të një fjale që nuk i kujtohet dhe kërkon të korrigohet;</li> <li>• të flasë në mënyrë të kuptueshme dhe pa hezitim, me pak pauza për të planifikuar atë që thotë, veçanërisht kur flet gjatë dhe lirshëm;</li> <li>• të theksojë atë pikë të informacionit që atij i duket më e rëndësishme;</li> <li>• të zotërojë një fjalor të mjaftueshëm për t'u shprehur lirshëm dhe të jetë në gjendje të perifrazojë për shumicën e temave që lidhen me jetën e përditshme.</li> </ul>
--	--

<b>Aftësia</b>	<b>Objektiva</b>
<b>Të lexhuarit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të kuptojë çështjet kryesore në artikujt të shkurtër gazetash apo revistash për tema aktuale dhe të njohura;</li> <li>• të lexojë intervista ose artikuj nëpër gazeta ose revista ku bëhet fjalë për tema ne ngjarje aktuale dhe të kuptojë në më mënyrë të përgjithshme thelbin e informacionit;</li> <li>• të nxjerrë nga konteksti i tematikave të njohura kuptimin e fjalëve të veçanta, të panjohura, si edhe të frazave apo shprehjeve më komplekse;</li> <li>• të gjejë dhe të kuptojë informacion apo fakte të kërkuara (kush, kur dhe ku është kryer diçka) duke i hedhur një vështrim të shpejtë teksteve të shkurtra;</li> <li>• të kuptojë informacionin më të rëndësishëm nga broshura të shkurtra të thjeshta me informacion nga jeta e përditshme;</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të kuptojë mesazhe të thjeshta dhe letra standarde rreth udhëtimeve, shërbimeve postare, blerjeve etj.;</li> <li>• të kuptojë mjaftueshëm ato pjesë të korrespondencës së tij që bëjnë fjalë për ngjarje, ndjenja apo dëshira të grupmohës së vet;</li> <li>• të kuptojë subjektin e një tregimi të strukturuar mirë dhe të dallojë ngjarjet dhe episodet më të rëndësishme në to;</li> <li>• të kuptojë tekste të shprehura me gjuhë të përdorimit të përditshëm;</li> <li>• të kuptojë në nivel të kënaqshëm tekste faktike për tema e subjekte që lidhen me interesat e tij.</li> </ul>
--	---

<b>Aftësia</b>	<b>Objektiva</b>
<b>Të shkruarit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të shkruajë tekste të thjeshta për tema të ndryshme duke lidhur në seri elementet e rëndësishme;</li> <li>• të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real apo imagjinar me fjali të thjeshta për një gazete shkolle apo rreth jashtëshkollor ku mund të bëjë pjesë;</li> <li>• t’u shkruajë letra shokëve apo të njohurve për të dhënë apo për të marrë informacion apo për të treguar për ngjarje apo ndodhi;</li> <li>• të shkruajë përmbajtjen e një libri për fëmijë, të një filmi apo koncerti;</li> <li>• të shkruajë duke shprehur në një letër ndjenjat e tij si trishtim, gëzim, interes, simpati apo keqardhje;</li> <li>• t’i përgjigjet me shkrim një lajmërimi dhe të kërkojë informacion plotësues për një produkt apo lajm që i duket me interes për veten;</li> <li>• të hartojë një faks apo e-mail, për të përcjellë në formë informacioni të thjeshtë te shokët apo kolegët ose të kërkojë informacion po në këtë mënyrë;</li> <li>• të shkruajë një CV në formë të përmbledhur.</li> </ul>

## 5. KËRKESA TË GJUHËS ANGLEZE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Në këtë program një rëndësi e veçantë i është kushtuar integritit ndërlëndor. Një aspekt shumë i rëndësishëm në mësimin e gjuhës së angleze është ai social dhe kulturor. Për këtë arsye duhet pasur parasysh mësimdhënia e integruar.

Përdorimi i një mësimdhënie të integruar mundëson aftësimin e nxënësve në përdorimin e njohurive gjuhësore në përgjithësi dhe të katër aftësive gjuhësore, në veçanti. Gjuha e huaj mësohet më mirë në kontekste të caktuara ku fushat tematike të parashtruara në këtë program trajtohen dhe në raport me lëndët e tjera. Gjuha e huaj mund të lidhet me lëndë të tilla si më poshtë:

Lidhja e gjuhës së huaj me *lëndët e matematikës, letërsisë, gjeografisë, historisë, artet, TIK, shkenca, sociale, shkencat natyrore etj.*

*Letërsia*, njohuritë e së cilës krijojnë një ide shumë të qartë për shkrimtarë dhe poetë të ndryshëm si edhe veprat e tyre dhe në këtë mënyrë mësojnë për periudha kohore të ndryshme si edhe ato bashkëkohore.

Lidhja me *shkencat natyrore* shprehet në trajtimin e temave të ndryshme që kanë të bëjnë me ndotjen e ambientit, mjedisin dhe ushqimin etj.

Me lëndën e *arteve* janë të lidhura temat të cilat kanë të bëjnë me sportin, muzikën, etj.

Me *historinë* janë të lidhura ngjarje dhe fakte të cilat ndihmojnë në formimin kulturor dhe intelektual të nxënësit në njohjen e vlerave historike- shoqërore të popujve anglisht-folës.

Bashkërendimi ndër-lëndor në programin e klasës së 11-të mundëson realizimin e synimeve dhe objektivave të përgjithshme të programit për:

*edukimin intelektual.* Përmes ndërthurjes së njohurive nxënësit arrijnë të analizojnë, të sintetizojnë dhe të vlerësojnë, duke rritur cilësinë.

*edukimin mjedisor.* Ndotja dhe mbrojtja e mjedisit janë tema që shoqërohen me fjalor dhe struktura gjuhësore të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

*edukimin kulturor dhe etik.* Përmes lëndëve historike dhe gjeografi, nxënësit fitojnë njohuri të reja për vendet anglishtfolëse. Këto njohuri ndërthuren me dijet për kulturën e këtyre vendeve, për zakonet e doket e tyre, për mënyrën e jetesës etj. Këtu nuk mund të lihen pa përmendur edhe shprehjet etike të këtyre popujve.

*edukimin për të drejtat e njeriut.* Njohja e kulturave të vendeve anglishtfolëse realizohet e lidhur ngushtë me temat e barazisë sociale, të diskriminimit racial, të respektit reciprok etj.

*atdheadashurinë.* Nxënësit ndërgjegjësohen për identitetin e tyre kombëtar duke njohur kulturat e popujve të vendeve anglishtfolëse e cila i mundëson ato që të bëjnë krahasime midis dy kulturave.

## 6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11-të është një dokument zyrtar si pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjuhës angleze dhe duhet të zbatohet nga mësues, autorë të teksteve etj.

Ky program mbështet ne dokumente të rëndësishme si:

- Kuadri i Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja
- Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar
- Standardet e arritjes

Programi i klasës së 11-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës angleze në nivelin **B1+**.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit, është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurrikulës së shkollave të mesme,
- synimeve të linjave ndërkurrikulare,
- vlerësimit të nxënësit me notë,
- parimeve të mësimdhënie-nxënies.

Është shumë e rëndësishme njohja dhe përvetësimi i programeve lëndore të lëndës së gjuhës angleze për klasën pasardhëse. Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

### A. Objektivat

Në këtë pikë duhet të kihet parasysh se një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Programi për klasën e 11-të është strukturuar në objektiva sipas standardeve dhe sipas aftësive që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-nxënësia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënës/it,-es dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet te objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

### B. Orët mësimore

Duhet të theksojmë se programi i gjuhës angleze për klasën e 11-të është strukturuar sipas një formati të ri i cili jep standarde sipas fushave dhe objektiva për secilin standard fushe; gjithashtu programi jep dhe objektiva për çdo aftësi dhe aftësi të cilat synojnë çka mësuesi do të arrijë në përfundim të vitit shkollor për këtë lëndë.

Më poshtë do të jepet sasia e orëve, e cila është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10%

(shitesë ose pakësim) orët e rekomanduara. Kjo do të thotë se mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së gjuhës angleze afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

### **Shpërndarja e orëve mësimore**

Gjuha angleze për klasën e 11-të zhvillohet me 4 orë mësimore në javë: **36 javë x 4 orë = 144 orë vjetore** dhe shpërndarja e orëve të planifikuara është si vijon:

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) fushat dhe aftësitë gjuhësore dhe linja (kultura) ndërthuren me njëra-tjetrën. Mësuesi është i lirë të bëjë kombinimin e tyre brenda një kapitulli ose një njësie mësimore, pavarësisht renditjes në tabelën e shpërndarjes së orëve.

***Komunikimi dhe formimi kulturor zë 101 orë***, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 70 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (nga të cilat 70%, që përbëjnë 50 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30%, që përbëjnë 20 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive; me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni) dhe 31 orë për aktet dhe funksionet e komunikimit (nga të cilat 70%, që përbëjnë 21 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e, d.m.th. 10 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës, d.m.th. ai jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull.).

Orët e përgjithshme për përpunimin e lëndës janë 43 orë, nga të cilat 5% e tyre, d.m.th. 6 orë, do të përdoren për përpunimin e të gjithë lëndës, ku vlerësimi tërësor i lëndës zë vendin e tij (p.sh., 3 orë mund të përdoren për përsëritjen dhe 3 orë për vlerësimin me shkrim e me gojë të dijeve që kanë përfutur nxënësit gjatë procesit të nxënies).

***Formimi gjuhësor zë 43 orë***. Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 30 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 13 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin e tyre).

Këtu duhet mbajtur parasysh, sigurisht, edhe përdorimi i gjuhës nga nxënës/i,-ja, pra përvetësimi i **aftësisë pragmatike** që do t'i lejojë atij ta përdorë gjuhën sipas qëllimeve të caktuara. Formimi gjuhësor gjithashtu duhet të privilegjojë aftësitë komunikative të gjuhës larg formave të mësimin tradicional të gramatikës.

## Përpunimi i njohurive

Me përpunim të njohurive kuptojmë rimarrjen dhe përforcimin e informacionit të marrë gjatë trajtimit tematik të përmbajtjes ose ushtrime për rifreskimin ose përsëritjen e strukturave gjuhësore ku nxënës/i,-ja ka shfaqur vështirësi.

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen e njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- testimin e njohurive-bazë;
- integrimin e njohurive të reja të lëndës me njohuritë e marra;
- integrimin e aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- përsëritjen vjetore;
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

Aftësive të përgjithshme si të komunikimit, menaxhimit të informacionit, zgjidhjeve problemore, të menduarit kritik dhe krijues;

Aftësive të posaçme lëndore si komunikimi gojor, shkrimi riprodhues e krijues, kuptimi i teksteve me vështirësi dhe gjatësi mesatare, kalimi nga kuptimi thelbësor te ai më i detajuar, kuptimi me gojë dhe ndërveprimi bisedor, etj.

Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe përforcuar konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

Mësuesi është i lirë të përdorë një larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/ nxënies për t'ia përshtatur nevojave të nxënësit/es në klasa të ndryshme. Ai i kombinon këto metoda gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencave gjuhësore dhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënës/it,-es në vijueshmëri të këtij procesi.

## Metoda dhe strategji të mësimdhënies/nxënies

Më poshtë disa strategji dhe teknika të ndryshme, sipas aftësive gjuhësore: dëgjim, të folurit, të lexuarit, të shkruarit.

Aftësia	Strategjitë
<b>Të dëgjuarit</b>	Të ndjekë përgjithësisht pikat kryesore të një diskutimi të gjatë; Të klasifikojë çështjet që dëgjon me kusht që gjuha të jetë standarde dhe e shqiptuar qartë; Të kuptojë përshkrimin e ngjarjeve, të ndjenjave dhe dëshirave në mënyrë të

	mjaftueshme për të mbajtur korrespondencë; Të kuptojë pikat kryesore të buletineve televizive ose radiofonike; Të komentojë shkurt pikëpamjen e një tjetri.
<b>Të dëgjuarit</b>	Të bëjë me lehtësi një përshkrim të drejtpërdrejtë dhe jo të ndërlikuar të temave të larmishme në fushën e tij duke e paraqitur atë si një vazhdimësi pikash lineare; Të përshkruajë një ngjarje reale ose imagjinare; Të përshkruajë një ëndërr, një shpresë ose një ambicie; Të tregojë hollësitë kryesore të një ngjarjeje të rastësishme si aksidentet.
<b>Të shkruarit</b>	Të shkruajë tekste të lidhura mbi një gamë temash të ndryshme në fushën e tij të interesit Të shkruajë përshkrime të hollësishme të thjeshta dhe të drejtpërdrejta mbi një gamë të gjerë temash të njohura Të shkruajë përshkrimin e një ngjarje ose të një udhëtimi të sapokryer Të përmbledhë me një farë sigurie një burim informacionesh faktike mbi tema të njohura të përditshme
<b>Të lexuarit</b>	Të përshkojë një tekst mjaft të gjatë për të gjetur një informacion që kërkon Të mbledhë informacione nga pjesë të ndryshme të tekstit për të përmbushur një detyrë specifike Të dallojë përfundimet kryesore të një teksti argumentues të ndërtuar qartë.

### **Parime për zbatimin e programit**

Më poshtë janë disa parime për zbatimin e programit:

#### **Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes**

Nxënësi duhet të jetë në qendër të procesit mësimor dhe të gëzojë të drejta të plota pjesëmarrjeje duke shprehur përvojën e tij jetësore. Kjo do të realizohet duke përzgjedhur tema, lloje të teksteve dhe forma sociale të orientuara sipas interesave dhe nevojave të moshës së klasës së 11-të duke pasur parasysh nivelin dhe rezultatet e tyre.

#### **Krijimi i mjedisit të të nxënës**

Mësuesit tanë duhet të ndërjegjësohen se është shumë e domosdoshme që nxënësi të ndihet i sigurt dhe kjo arrihet nëpërmjet krijimit të një mjedisi shkollor fizik, emocional, sfidues dhe jofrenues për procesin mësimor i cili mundëson një mësimdhënie/nxënie që plotëson ndjeshëm nevojat dhe objektivat e përcaktuar më parë.

#### **Organizimi i klasës**

Vendosja e nxënësit në qendër të procesit mësimor do të sjellë ndryshimin e rolit tradicional të mësuesit. Mësuesi do të jetë organizues, furnizues dhe orientues për nxënësit. Ai do t'i ndihmojë nxënësit për një të mësuar të qëndrueshëm. Mësuesi ka më tepër rol planifikues sesa burim i të gjitha njohurive në klasë.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikative, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe ajo e situatave sa më afër jetës reale etj.

Mësuesi është i lirë dhe i pavarur në përdorimin e metodave dhe materialeve mësimore që mbështetin krijimtarinë dhe pavarësinë mendore si të nxënësve, ashtu edhe të mësuesve.

Organizimi i mësimit mundëson punën në grupe dhe nxit lirshmërinë e nxënësve. Atmosfera e klasës është mbështetje dhe respekt për përgjigjen e nxënësit si nga mësuesi, ashtu edhe nga nxënësit e tjerë. Nxënësi ndërkohë mëson edhe nga shokët dhe shoqet e tij.

## **Të mësuarit bashkëveprues**

Mësimi i anglishtes i drejton nxënësit drejt pavarësisë në rritje në përfitim të gjuhësor e mundësuar kjo nëpërmjet aktiviteteve përkatëse të të mësuarit, formave të larmishme sociale. Duhet të theksojmë rolin e veçantë që duhet të zënë puna me grupe, me partner. Puna në grupe ndihmon, gjithashtu, në shoqërimin e nxënësve, i bën ata bashkëveprues me njëri-tjetrin dhe me mësuesit, nxit tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

## **Puna e diferencuar**

Më qëllim që metodat e mësimdhënies/nxënies, parimet dhe strategjitë mbi të cilat realizohen këto metoda të kenë arritje sipas standardeve të përcaktuara, mësuesi planifikon punën e diferencuar me nxënësit.

Duke pasur parasysh përbërjen heterogjene të klasave tona, mësuesi duhet të parapëlqejë punën në grupe, kështu ai mund të krijojë grupe të përziera me nxënës/e të përparuar dhe të prapambetur; duke caktuar detyra në grup për të mos i vënë në vështirësi këta nxënës dhe për t'i inkurajuar të zgjidhin ato detyra që munden. Mësuesi mund t'u japë gradualisht detyra plus për të siguruar një nivelim të tyre me të tjerët, por duke bërë kujdes që të mos rrisë vështirësitë e tyre dhe duke gjetur detyra motivuese e tërheqëse.

Një motivim i mirë për thellimin e njohurive të anglishtes, konkretisht për nxënësit e përparuar është puna e veprimtarive shtesë, si përzgjedhje e materialeve autentike, krijime me shkrim në kuadër konkurruesh, recitime ose vënie në skenë të pjesëve të ndryshme në gjuhë të huaj etj. Ai mund të përdorë punën e këtyre nxënësve për të realizuar bashkë me ta një aspekt shumë të rëndësishëm të metodologjisë së zbatimit të programit si integrimi lëndor, ku nxënësit e përparuar mund të sjellin një kontribut të konsiderueshëm nëpërmjet transferimit të njohurive të tyre nga gjuha dhe kultura amtare në gjuhën dhe kulturën e huaj dhe anasjelltas.

Si rekomandim, më poshtë paraqiten disa teknika për tërheqjen e të gjithë nxënësve në procesin mësimor:

- të ketë vullnetin dhe dëshirën për t'i dëgjuar dhe për t'u dhënë përgjigje nxënësve;
- të ndjekë klasën në çdo hap, brenda dhe jashtë saj;
- të ndajë përgjegjësitë atje dhe atëherë kur duhet, për çështje vendimmarrjeje, detyra shtëpie apo klase, detyra me shkrim etj.;
- të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve;
- të kërkojë prej tyre vlerësime të punës së tij, me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive.
- të shmangë çdo gjë që nuk i përshtatet moshës së nxënësve;
- të zgjedhë materiale për mësim në përputhje me kërkesat dhe standardet e programit mësimor;

- nëse diçka nuk ecën në klasë, përpiqet ta mënjanojë dhe të përdorë punën në grup ose, për individë të veçantë, punën individuale;
- të përdorë ushtrime që kërkojnë pjesëmarrje aktive, duke nxitur edhe nxënësit me dije jo të plota të përfshihen në to;
- të shmangë ushtrime që i vënë këta nxënës në vështirësi dhe i zënë ngushtë;
- të motivojë nxënësin edhe për një detyrë fare të vogël që ka bërë, me qëllim që të rritet dëshira dhe përgjegjësia për mësimin e gjuhës së huaj;
- të mos paragjykojë nxënësit, por përkundrazi t'u japë ushtrime që kërkojnë vëmendje dhe punë.

## 7. VLERËSIMI

Vlerësimi i përparimit të nxënësit do të realizojë matjen e përparimit dhe arritjeve të nxënësve në gjuhën e huaj, ai duhet të jetë objektiv dhe i matshëm. Të vlerësosh nxënësin është jo e lehtë dhe kjo mund të bëhet në mënyra nga më të ndryshmet.

### Vlerësim diagnostikues

Ky vlerësim do të realizohet përmes njohjes dhe vlerësimit të arritjeve dhe mangësive , duke i dëgjuar nxënësit të flasin dhe lexojnë, duke vëzhguar të shkruarit e tyre dhe duke analizuar llojet e produkteve të tyre në procesin mësimor. Ky lloj vlerësimi jep informacion për efektshmërinë e të nxënit.

Ndihmon në gjetjen e mënyrës së veprimit në etapën e dytë të të mësuarit dhe ndihmon në gjetjen e arsyeve të mospërvetësimit të koncepteve.

### Vlerësim formues

Nëpërmjet këtij vlerësimi synohet të theksohet ajo çfarë ka arritur nxënësi gjatë procesit të formimit të njohurive. Ky vlerësim kryhet në fillim: për vendosjen e objektivave në procesin mësimor, gjatë vitit: për të vlerësuar ecurinë e njohurive të fituara, për përmirësim si dhe në fund të vitit për të parë se çfarë është arritur.

Më poshtë sugjerohen disa veprimtari ose kërkesa për vetë-vlerësimin formues:

- të shpjegohen objektivat pedagogjike të veprimtarive;
- pas një veprimtarie të bëhet një pushim dhe të bëhet pyetja “Çfarë keni mësuar?”;
- t'i kërkohet rregullisht nxënësit të bëjë bilancin e njohurive të ndryshme;
- të shpallen provimet e vlerësimit përmbledhës dhe të përcaktohen paraprakisht kriteret e suksesit;
- në një situatë suksezi, të pyeten nxënësit “Çfarë bëtë për të pasur sukses?” dhe të nxiten ata të shkëmbejnë përvojën e tyre mbi këtë temë;
- pas një krijimi me shkrim, t'i kërkohet nxënësit të tregojë çdo gjë për të cilën është i sigurt në tekstin e tij (duke nënvizuar, për shembull);
- në rast mëdyshjeje mbi një formë ortografike, leksikore ose morfologjike, t'i kërkohet nxënësit ta shënojë këtë formë në tekstin e tij dhe të hartojë pyetjen në fund të faqes në formë shënimi (mësuesi i përgjigjet në të njëjtën mënyrë).



## Vlerësim përmbledhës

Ky vlerësim bëhet në fund të një numri temash, njësisish, detyrash e kapitujsh, ose në fund të një periudhe të caktuar kohore.

## Vlerësim motivues

Ky vlerësim ka për qëllim të nxisë interesin dhe dëshirën e nxënësve për të mësuar. Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program. Objektivi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm. Asgjë nuk është më nxitës sesa suksesi i arritur duke u përballur me gjendjen reale në të cilën ndodhet një nxënës.

Do të inkurajohen nxënësit të njohin procedurat e vlerësimit si mundësi për *vetëvlerësim*.

*Vetëvlerësimi* është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës italiane, ku secili jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësuesi.

Vetëvlerësimi ka efekt kur ai u referohet normave dhe kapacitetit që korniza e gjuhëve parashtron për grup-moshën e tyre dhe kur ky vlerësim është i lidhur me një përvojë të veçantë, që mund të jetë ajo e kalimit të testeve. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e tyre në vazhdimësi.

Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli Evropian Gjuhëve (PEGJ), që me anë të tri pjesëve të tij Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë gjuhësore dhe Dosjes, nxisin nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore që mund të jenë provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare.

PEGJ është dokumenti në të cilin çdo nxënës që mëson ose ka mësuar një gjuhë që mësohet në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe përvojat kulturore. PEGJ e nxit nxënësin të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste dhe të vazhdojë t'i mësojë gjuhët përgjatë gjithë jetës. PEGJ e nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe aftësinë e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. PEGJ kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Evropë nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë të kulturave të tjera dhe ndihmës së kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësuesi dhe nxënësit bëjnë komentimin përfundimtar.

Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.

Nxënësi mban shënime arritjet e tij, duke përdorur edhe gjuhën amtare.

Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin që ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxënit e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi.

Nxënësit do të nxiten të zhvillojnë të menduarit e pavarur dhe vetëdijen për aftësinë e tyre për përmirësime përmes kuptimit të hollësishtëm të procedurave të vlerësimit.

Nëpërmjet vlerësimit vetëvlerësues nxënësit vlerësojnë veten nëpërmjet një pyetësi mbi atë se "çfarë di të bëj?".

Vetëvlerësimi është një formë e re, por tashmë mjaft e përhapur në botën arsimore. Ai është pjesë e të mësuarit të pavarur, dhe konsiderohet mjaft i nevojshëm jo vetëm nga nxënësit por edhe nga mësuesit. Është detyrë e çdo mësuesi të shpjegojë e njohë nxënësit me përmbajtjen e vetëvlerësimit, përdorimi i të cilës do të sjellë ndërgjegjësim të mëtejshëm të problemeve të të mësuarit.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve dhe as vendosjen e notave në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara nga orët e kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

**Vlerësimi me shkrim** shërben për aftësimin në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të realizuara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon **provime periodike** me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektivi të veçantë të të nxënit, deri tek ato njëorëshe; teste me alternativë ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe **provimi përfundimtar**.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi është në rolin e atij që drejton, që rekomandon.